



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOLEGJI ZGJEDHOR GJYQËSOR
TIRANË

Nr.3 Regj.Them.
Datë Rregj. 25.03.2021

Nr.3 VENDIMI
Datë 29.03.2021

V E N D I M

“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor i mbledhur pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë me trup gjykues të përbërë nga:

Gjyqtare: Alma KOLGJOKA (*Relatore*)
Gjyqtar: Asim VOKSHI (*Anëtar*)
Gjyqtare: Esmeralda XHILI (*Anëtare*)
Gjyqtar: Gentian MEDJA (*Anëtar*)
Gjyqtare: Manjola XHAXHO (*Anëtare*)

me sekretare gjyqësore Erjona Torba, sot më datë 29.03.2021, në seancë gjyqësore me dyer të hapura, mori në shqyrtim çështjen me nr.3 Akti, datë 25.03.2021 që i përket:

PADITËS: **Partia Socialiste e Shqipërisë**, me adresë: Sheshi “Austria”, Tiranë, përfaqësuar me Autorizimin nr.99, datë 26.03.2021 nga Av.Eridian Saliçani dhe Av.Maringlen Legisi, anëtarë të Dhomës së Avokatisë Tiranë.

IPADITUR: **Komisioni Qendror i Zgjedhjeve**, përfaqësuar në gjykim me Autorizimin nr.2751 Prot., datë 28.03.2021 nga Z. Erion Meta dhe Z. Olsi Petro.

PERSON I INTERESUAR: **Koalicioni “Partia Demokratike-Aleanca për Ndryshim (PD-PR-PDIU-PAA-PBDNJ-PDK-LZHK-PLL-FRD-BLD-PBKD-PBD-PKD) “PD-AN”**

përfaqësuar me Autorizimin nr.Extra Prot., datë 01.03.2021, nga Z. Ivi Kaso.

OBJEKTI: Ndryshimin e vendimit nr.9 datë, 23.03.2021 të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve (K.A.S.) dhe lënien në fuqi të vendimit nr.156, datë 17.03.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve (K.SH.Z).

BAZA LIGJORE:Neni 3, pika 2, neni 67, neni 98, pika 4, neni 145, neni 158, pika 1, germa “b” të ligjit 10019, datë 29.12.2008 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, i përditësuar.

Gjykata pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, administroi provat në seancë gjyqësore, dëgjoji pretendimet e fundit të palëve, ku:

Pala paditëse, Partia Socialiste e Shqipërisë kërkoi:

- Pranimin e padisë sipas objektit.

Pala e paditur, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve kërkoi:

- Lënien në çmim të gjykatës.

Personi i interesuar, Koalicioni “Partia Demokratike-Aleanca për Ndryshim” kërkoi:

- Rrëzimin e padisë.

VËREN:

1. Se pala paditëse, Partia Socialiste e Shqipërisë i është drejtuar Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor me kërkesëpadi më datë 25.03.2021, duke kërkuar “*Ndryshimin e vendimit nr.9 datë 23.03.2021 të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve (K.A.S.) dhe lënien në fuqi të vendimit nr.156 datë 17.03.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve (K.SH.Z)*”.

I. FAKTET E ÇËSHTJES:

2. Presidenti i Republikës, në mbështetje të neneve 65, pikat 1 dhe 2, 92 shkronja “gj”, e 93 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe të neneve 8, 9, pikat 1 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës

së Shqipërisë” të ndryshuar, me Dekretin nr. 11700, datë 06.09.2020, ka caktuar datën 25 Prill 2021 për zhvillimin e zgjedhjeve për Kuvendin.

3. Me vendimin nr.107, datë 2.3.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, Koalicioni “Partia Demokratike-Aleanca për Ndryshim (PD-PR-PDIU-PAA-PBDNJPKD-LZHK-PLL-FRD-BLD-PBKD-PBD-PKD)” është regjistruar si subjekt zgjedhor, për zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 Prill 2021. Në bazë të nenit 67 dhe nenit 72 të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, Koalicioni “Partia Demokratike-Aleanca për Ndryshim (PD-PR-PDIU-PAA-PBDNJ PDK-LZHK-PLL-FRD-BLD-PBKD-PBD-PKD)” ka paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dokumentacionin për miratimin e listave shumë emërore më datë 8.3.2021.

4. Në bazë të nenit 73 të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ka verifikuar listat shumë emërore të kandidatëve për deputet të koalicionit “Partia Demokratike-Aleanca për Ndryshim (PD-PR-PDIU-PAA-PBDNJ PDK-LZHK-PLL-FRD-BLD-PBKD-PBD-PKD)”, “PD-AN” dhe dokumentacionin bashkëngjitur të paraqitur. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve në përfundim të procesit të verifikimit paraprak, pasi janë konstatuar mangësi, është shprehur me vendimin nr. 131 datë 10.03.2021. Sipas përmbajtjes së vendimit rezultojnë ndër të tjera se:

- “1. Zona Zgjedhore Qarku Elbasan ka 21 kandidatë nga 15 kandidatë që kërkohet sipas nenit 67, pika 4, të Kodit Zgjedhor, duke paraqitur 6 kandidatë më shumë.
2. Zona Zgjedhore qarku Dibër ka 9 kandidatë nga 6 kandidatë që kërkohet sipas nenit 67, pika 4, të Kodit Zgjedhor, duke paraqitur 3 kandidatë më shumë.
3. Zona Zgjedhore qarku Fier ka 24 kandidatë nga 18 kandidatë që kërkohet sipas nenit 67, pika 4, të Kodit Zgjedhor, duke paraqitur 6 kandidatë më shumë.
4. Zona Zgjedhore qarku Berat ka 12 kandidatë nga 9 kandidatë që kërkohet sipas nenit 67, pika 4, të Kodit Zgjedhor, duke paraqitur 3 kandidatë më shumë.
5. Zona zgjedhore qarku Durrës ka 21 kandidatë nga 15 kandidatë që kërkohet sipas nenit 67, pika 4, të Kodit Zgjedhor, duke paraqitur 6 kandidatë më shumë.
6. Zona zgjedhore, qarku Korçë ka 21 kandidatë nga 12 kandidatë që kërkohet sipas nenit 67, pika 4, të Kodit Zgjedhor duke paraqitur 9 kandidatë më shumë.
7. Zona zgjedhore, qarku Kukës ka 9 kandidatë nga 3 kandidatë që kërkohet sipas nenit 67, pika 4, të Kodit Zgjedhor duke paraqitur 6 kandidatë më shumë.
8. Zona zgjedhore qarku Lezhë ka 12 kandidatë nga 9 kandidatë që kërkohet sipas nenit 67, pika 4, të Kodit Zgjedhor duke paraqitur 3 kandidatë më shumë.
9. Zona zgjedhore, qarku Shkodër ka 21 kandidate nga 12 kandidatë që kërkohet sipas nenit 67, pika 4, të Kodit Zgjedhor duke paraqitur 9 kandidatë më shumë.;

10. Zona zgjedhore, qarku Tiranë ka 45 kandidatë nga 36 kandidatë që kërkohet sipas nenit 67, pika 4, të Kodit Zgjedhor, duke paraqitur 9 kandidatë më shumë.
11. Zona zgjedhore, qarku Vlorë ka 18 kandidatë nga 12 kandidatë që kërkohet sipas nenit 67, pika 4, të Kodit Zgjedhor, duke paraqitur 6 kandidatë më shumë.
12. Zona Zgjedhore qarku Gjirokastër ka 9 kandidatë nga 6 kandidatë që kërkohet sipas nenit 67, pika 4, të Kodit Zgjedhor, duke paraqitur 3 kandidatë më shumë.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka vendosur:

1. Kthimin për korrigjim, sipas gjetjeve të renditura më sipër, të dokumentacionit për regjistrimin e listës shumë emërore të kandidatëve për deputet, të koalicionit “Partia Demokratike-Aleanca për Ndryshim (PD-PR-PDIU-PAA-PBDNJ-PDK-LZHK-PLL-FRD-BLD-PBKD-PBD-PKD)”, “PD-AN”, për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021.
2. Dokumentacioni i korrigjuar të depozitohet brenda datës 16.03.2021.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 3 ditëve në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve.

5. Koalicioni “Partia Demokratike-Aleanca për Ndryshim (PD-PR-PDIU-PAA-PBDNJ-PDK-LZHK-PLL-FRD-BLD-PBKD-PBD-PKD)” nuk ka ushtruar ankim kundër këtij vendimi, duke riparaqitur listat e reja. Në përfundim të shqyrtimit administrativ, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, me vendimin nr.156 datë 17.03.2021 ka vendosur:

1. Miratimin e listave shumë emërore të Koalicionit “Partia Demokratike - Aleanca për Ndryshim (PD-PR-PDIU-PAA-PBDNJ-PDK-LZHK-PLL-FRD-BLD-PBKD-PBD-PKD)”, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill, sipas lidhjes nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi për zonat Zgjedhore Qarku Berat për kandidatët e radhitur nga numri 1 deri në numrin 9, Qarku Dibër për kandidatët e radhitur nga numri 1 deri në numrin 6, Qarku Durrës për kandidatët e radhitur nga numri 1 deri në numrin 15, Qarku Elbasan për kandidatët e radhitur nga numri 1 deri në numrin 15, Qarku Fier për kandidatët e radhitur nga numri 1 deri në numrin 18, Qarku Gjirokastër për kandidatët e radhitur nga numri 1 deri në numrin 6, Qarku Korçë për kandidatët e radhitur nga numri 1 deri në numrin 12, Qarku Kukës për kandidatët e radhitur nga numri 1 deri në 3, Qarku Lezhë për kandidatët e radhitur nga numri 1 deri në numrin 9, Qarku Shkodër për kandidatët e radhitur nga numri 1 deri në numrin 12, Qarku Tiranë për kandidatët e radhitur nga numri 1 deri në 36 dhe Qarku Vlorë për kandidatët e radhitur nga numri 1 deri në numrin 12.

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 3 ditëve në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka arsyetuar:

“...Në përputhje me parashikimet e nenit 64 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Kuvendi përbëhet nga 140 deputet (mandate).

Komisioni Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, me vendimin nr.7, datë 11 dhjetor 2020 ka përcatuar numrin e mandateve për çdo zonë zgjedhore për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021, si vijon: Berat 7, Dibër 5, Durrës 14, Elbasan 14, Gjirokastrë 4, Fier 16, Korçë 11, Kukës 3, Lezhë 7, Shkodër 11, Tiranë 36, Vlorë 12, në total 140 deputetë. Sa parashikon neni 67 pika 4 e Kodit Zgjedhor më sipër cituar, është një përcaktim që nuk tregon numrin minimal të kandidatëve në listën shumëmërore, por tregon sesa është ky numër. Në kuptim të përmbajtjes së kësaj pike të Kodit Zgjedhor, ky numër i kandidatëve në listën shumëmërore përcaktohet nga tre elementë apo tre kritere:

1. Numrin e mandateve në zonën zgjedhore
2. Numrin 2 (dy), (pra shtuar 2 (dy));
- 3- Plotëpjesëtimin me numrin 3 (për respektimin e kuotës gjinore.

Pra, rregullat që burojnë nga parashikimi i nenit 67, pika 4 e Kodit Zgjedhor janë si më poshtë:

- Është detyrim për partitë politike që numri i kandidatëve në listën shumëmërore nuk mund të jetë më i vogël se numri i mandateve që do të zgjidhen në atë zonë. Pra, duke marrë si shembull rastin e Dibrës (5 mandate me vendimin e KRR) theksojmë se partitë politike nuk mund të sjellin listë me 4 emra, pra me një numër më të vogël se numri i mandateve për atë zonë zgjedhore. Shprehja “shtuar dy” lë vend për interpretim. Interpretimi lind pasi togfjalëshi “në çdo rast” që fillon fjalia vijuese, lë të kuptohet se situata e parashikuar në rregullin e parashikuar nga fjalia e parë nuk mund të jetë vetëm një (pra, numri i mandateve në zonë, plus dy), por lë të kuptohet se mund të ketë më shumë se 1 (një) që mund të jetë ose jo i plotëpjesëtueshëm me numrin 3 (tre). Marrim sërish rastin e Dibrës me 5 mandate. Në rast se do ta interpretonim nenin 67, pika 4, vetëm me një rast parashikimi (pra numrin e mandateve në zonë plus 2 (dy)) atëherë në rastin e Dibrës do të gjendeshim në situatën që numrit 5 t'i shtonim 2, d.m.th, $5+2=7$ kandidatë në listat shumëmërore. Edhe numri 5 edhe numri 7 nuk janë të plotëpjesëtueshëm me numrin 3 (tre). Pra, në këtë mënyrë interpretimi të nenit, është e pamundur të respektonim parashikimin ligjor. Kjo situatë vihet re edhe në zonat zgjedhore Durrës ($14+2=16$), Elbasan ($14+2=16$), Korçë ($11+2=13$), Kukës ($3+2=5$), Shkodër ($11+2=13$), Tiranë

$(36+2=38)$ dhe Vlorë $(12+2=14)$. Të gjithë rastet nuk janë të plotëpjesëtueshëm me numrin 3 (tre). Në këtë mënyrë të interpretuari, formula nuk është funksionale.

- Për të kapërcyer situata të tilla, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve çmon se, rregulli vijues pas rregullit në pikën 1, për zbatimin e nenit 67, pika 4, duhet të jetë i tillë që, në rastet kur numri i mandateve për çdo zonë zgjedhore, të përcaktuar me vendimin e KRR cituar më sipër, është i plotëpjesëtueshëm me numrin tre (3), atëherë nuk është e nevojshme shtesa në numrin e kandidatëve në listat shumëemërore.
- Në rastet kur numri i mandateve për zonën zgjedhore nuk është i plotëpjesëtueshëm me numrin 3 (tre) i shtohet 1 (një) për ta bërë të plotëpjesëtueshëm me numrin tre (3) dhe në rast se sërish shumta është jo e plotëpjesëtueshme me numrin 3, atëherë i shtojmë 2. Në këtë mënyrë, respektohet edhe limiti prej 2 mandatësh shtesë që ka parashikuar dispozita dhe në të njëjtën kohë bëhet e zbatueshme.

Është e qartë se dispozita në fjalë (neni 67, pika 4 i Kodit Zgjedhor) përcakton numrin e kandidatëve për deputetë në listat shumëemërore të paraqitura në KQZ. Dispozita përcakton ekzaktësisht sa do të jetë numri i kandidatëve për deputetë dhe nuk përcakton numrin minimal, sepse përndryshe do të duhej qëligjvënësi të kishte përcaktuar edhe se sa do të ishte numri maksimal ose do të duhej t'ia kishte lënë këtë kompetencë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Por kjo dispozitë mungon. Sa më sipër është një argument logjik për të theksuar edhe njëherë se është pikërisht parashikimi i nenit 67, pika 4 që përcakton numrin e kandidatëve për deputetë në listat shumëemërore të subjekteve zgjedhore.

Ratio (themeli i një zgjedhje ligjore) e normës juridike është të vendosë kufirin e sipërm të listës, pasi kufiri i poshtëm është sa numri i mandateve. Kufiri i sipërm i listës së kandidatëve është numri më i afërt i plotëpjesëtueshëm me 3 i numrit të mandateve, deri 2. Infiniti nuk është ratio i normës.

Më tej, vlerësoj se, ndonëse numri i kandidatëve i listës shumëemërore nuk është në përputhje me përcaktimet e Kodit Zgjedhor, nuk jemi në kushtet ligjore të refuzimit të listës të parashikuara në nenin 67 pika 7 e Kodit Zgjedhor ku parashikohet se: “Në rast mospërbushjeje të njërit prej kushteve të parashikuara në këtë nen, në lidhje me përbërjen e listës shumëemërore KQZ-ja zbaton sanksionet e parashikuara në nenin 175 të Kodit Zgjedhor”. Neni 175 i Kodit Zgjedhor parashikon sanksionin për mosrespektim të barazisë gjinore si vijon: “mospërbushja nga subjekti zgjedhor i detyrimit të parashikuar në pikën 6 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor passjell refuzimin e listës shumëemërore për t’u regjistruar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve”.

Do të ishim përpara shkaqeve për refuzimin e listës nëse nuk do të ishte respektuar kuota gjinore. Dhe ky nuk është rasti, pasi subjekti zgjedhor e ka respektuar kuotën gjinore. Do të përbënte shkak për refuzim të listës nëse nuk do të kishim një listë kandidatësh për çdo qark, gjë që ky koalicion e ka respektuar, ne kemi listën për çdo qark, dhe nëse numri i kandidatëve nuk do të ishte aq sa kërkon Kodi Zgjedhor. Në rastin konkret kemi një numër më të madh kandidatësh sesa kërkon Kodi Zgjedhor, kështu që, në këto rrethana vlerësoj se nuk jemi në kushtet ligjore për të refuzuar listën...”

6. Koalicioni Partia Demokratike–Aleanca për Ndryshim (PD-AN), brenda afatit kohor ka depozituar pranë Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve, kërkesën ankimore nr.05 datë 19.3.2021 duke animuar vendimin nr.156 datë 17.03.2021 si dhe arsyetimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Ankimuesi në mënyrë të përmbedhur ka pretenduar “Dispozita e pikës 4 të nenit 67 të KZ është për subjektin ankues dispozitë që vendos numrin minimal që duhet të ketë lista e kandidatëve dhe nuk përmban “ndonjë parashikim për ndonjë numër maksimal kandidatësh”. Pala ankimuese në argumentet e saj citon se “Parashikimi i legjislatorit në formulimin e nenit 67, pika 4 në ndryshimet e fundit të Kodit Zgjedhor, vjen në një linjë me parashikimet dhe formulimet e mëparshme të kësaj dispozite, të cilat nuk parashikonin kufi maksimal kandidatësh në listat shumë emërore, por vetëm kufi minimal”. Modifikimet që i janë bërë dispozitës kanë synuar vetëm zbatimin eficient të kuotës gjinore. Së fundi, për subjektin ankues Komisioneri ka disponuar përtej tagrave të veta ligjore, kur ka miratuar në mënyrë të pjesshme listat e kandidatëve të tij.”

7. Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve me vendimin nr.9, datë 23.03.2021 ka vendosur:

1. Pranimin e Kërkesës Ankimore nr.05 datë 19.03.2021 të subjektit zgjedhor koalicioni Partia Demokratike-Aleanca për Ndryshim (PD-AN).

2. Ndryshimin e vendimit nr.156. datë 17.03.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për shqyrtimin e kërkesës për regjistrimin e listave shumëemërore të koalicionit Partia Demokratike-Aleanca për Ndryshim (PD-PR-PDIU-PAA-PBDNJ-PDK-LZHK-PLL-FRD BLD-PBKD-PBD-PKD) për zgjedhjet për kuvendin të datës 25 prill 2021”.

3. Regjistrimin e listave shumëemërore të subjektit zgjedhor koalicionit Partia Demokratike-Aleanca për Ndryshim, sipas listës së depozituar në datën 16.03.2021 pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Administrativ, Tiranë brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve ndër të tjera ka arsyetuar:

“...1.Kushtet e listuara në nenin 67 të Kodit Zgjedhor janë kumulative. Ato nuk janë të vetmet, sepse kushte të tjera specifikohen në dispozita të tjera të kreut përkatës. Por nuk ka asnjë dyshim, se ato duhet të plotësohen të gjitha. Këto kushte (edhe ato formalet) kanë forcën të krijojnë ose shuajnë marrëdhënie juridike të një rëndësie të posaçme. Kështu p.sh. rendi shifror ka lidhje të drejtpërdrejtë me fitimin ose jo të mandatit të deputetit, përkatësia partiake e kandidatit të koalicionit ka lidhje me mbështetjen financiare për partinë politike, të cilës i përket ai, numri minimal i kandidatëve në listë me sigurinë për qëndrueshmëri institucionale etj.. Prandaj ligjvënësi ka caktuar KQZ-në të mbikëqyrë plotësimin e tyre dhe i ka dhënë tagrin Komisionerit që t’ia kthejë dokumentacionin subjektiv për plotësim, me paralajmërimin për refuzimin e listës.

2. K.A.S.-i mban qëndrim të njëjtë me palën ankuese, në vlerësimin se Komisioneri nuk ka tagra për të ndërhyrë në përmbajtjen e listës, për t’a modifikuar atë, qoftë sipas vullnetit të tij, qoftë sipas vullnetit të ligjit. Lista është vullnet sovran i subjektivit dhe i kandidatëve që pranojnë kandidimin. Edhe detyrimi për plotësimin e kushteve është detyrim i subjektivit.

Komisioneri ka vetëm tagrin e verifikimit, kthimit për korrigjim dhe miratimit ose refuzimit të saj. Mosplotësimi i çdonjërit prej kushteve të listuara në nenin 67 ka pasojë refuzimin e regjistrimit të listës shumëmemërore të subjektivit. Kjo pasojë deklarohet qartë në pikën e fundit të nenit 67 ku parashikohet se “në rast mospërmbushjeje të njërit prej kushteve të parashikuara në këtë nen, në lidhje me përbërjen e listës shumëmemërore K.Q.Z.-ja zbaton sanksionet e parashikuara në nenin 175 të këtij Kodi”. Në vendimin e tij nr.156 datë 17.3.2021, Komisioneri ka vlerësuar se, midis tyre, vetëm kushtet sipas shkronjave “a” dhe “h” më sipër, passjellin refuzimin, kurse të tjerat jo. Ky lexim është i pambështetur dhe përplaset haptazi me dispozitën e pikës së fundit të nenit 67, e cila i quan njësoj të vlefshme të gjitha kushtet.

3. Pika 4 e nenit 67 kërkon që numri i kandidatëve në listën shumëmemërore të subjektivit për secilën zonë zgjedhore të mos jetë më i vogël se numri i mandateve që do të zgjidhen në zonën zgjedhore përkatëse, shtuar dy. Interpretimi gjuhësor i dispozitës, për shkak të togfjalëshit “numri jo më i vogël se...” të çon automatikisht tek konkluzioni, se dispozita vendos kufirin minimal të kandidatëve të listës tek shifra “numër mandatesh shtuar/plus dy”.

Kjo do të thotë p.sh.se lista e Kukësit me 3 kandidatë, e Tiranës me 36 kandidatë dhe e Vlorës me 12 kandidatë (sikurse rezulton nga vendimi i Komisionerit nr.156

datë 17.3.2021) vijnë në kundërshtim me kriterin sipas kësaj fjalie, sepse i mungon shtesa prej dy kandidatësh që duhet për efekt të saj. Nëse dispozitën e vlerësojmë sipas interpretimit historik të saj do të konstatojmë se edhe përpara ndryshimeve të vitit 2020 të Kodit Zgjedhor, kur dispozita kishte përmbajtjen “Numri i kandidatëve në listën shumemërore të një partie të regjistruar si subjekt zgjedhor më vete apo numri i përgjithshëm i kandidatëve të një koalicioni nuk duhet të jetë më i vogël sesa numri i mandateve që do të zgjidhen në zonën zgjedhore përkatëse. Për një parti pjesëtare të koalicionit, numri i kandidatëve nuk mund të jetë më i vogël sesa gjysma e mandateve që zgjidhen në zonën zgjedhore përkatëse”, kushti është lexuar si kusht që vendoste kufirin minimal të kandidatëve të listës. Vetëm se me ligjin e vjetër, kufiri ishte i ndryshëm.

4. Pika 4 e nenit 67 ka përcaktuar kufirin minimal të kandidatëve të listës, sepse shqetësimi i shprehur i ligjvënësit ka qenë gjithmonë funksionaliteti në vazhdimësi i Kuvendit. Pra, numri minimal i listës nuk ka lidhje me zgjedhjet dhe subjektet zgjedhore. Ai është aty për të mbrojtur Kuvendin. Eksperiencat e mëparshme politike kanë kultivuar praktikën e furnizimit të radhëve të qeveritarëve, diplomatëve, gjyqtarëve apo funksionarëve të tjerë të lartë të shtetit me deputetë që heqin dorë nga mandati, gjë që afronte ezaurimin e listave. Ky kufi u rrit me amendamentet e Kodit Zgjedhor të vitit 2020, në kontekstin historik të funksionimit të Kuvendit me vetëm 128 deputetë. Ky kontekst dhe sidomos debati rreth listave të qarqeve me pak mandate (Kukësi, Gjirokastra, Dibra) u vunë në themel të vendimit të ligjvënësit pro shifrës “jo më pak se numri i mandateve shtuar/plus dy”. Analiza e dispozitës në këndvështrimin historik nuk gjen argument në favor të tezës se “ratio e normës juridike është të vendosë kufirin e sipërm të listës, pasi kufiri i poshtëm është sa numri i mandateve”, sikurse thuhet në vendimin nr.156 datë 17.3.2021. Kufiri i sipërm i listës nuk rezulton të ketë qenë shqetësim për ligjvënësin, as me dispozitën aktuale, as me atë para ndryshimeve. Kuadri ligjor i mëparshëm dhe zgjedhjet e mëparshme nuk kanë operuar me kufi të sipërm të shprehur. Kufirin e caktonte vetë subjekti kur depozitonte listat. Në zgjedhjet e vitit 2017 p.sh. ankuesi e ka caktuar kufirin e sipërm për qarkun e Tiranës në shifrën 50 nga 34 mandate, për qarkun e Durrësit në 19 nga 12 mandate, për Elbasanin në 20 nga 14 mandate, për Gjirokastrën në 9 nga 5 mandate etj.. Kjo liri veprimi në vitin 2017 as është kontestuar dhe as është vënë në dyshim.

5. Mungesa e kufirit të sipërm të shprehur nuk e bën listën pa kufi. Konkluzioni se lista është infinit është i gabuar. Sa kohë që numri i kandidatëve në listë varet nga nevojat, interesat elektorale dhe mundësitë e vetë subjektit, lista është fleksibël (ndryshon nga një subjekt tek tjetri), por jo infinit.

6. Ligjvënësi, me ndërhyrjet e herëpashërëshme, nuk ka preferuar t'i vendosë listës kufi të sipërm, sepse praktikat zgjedhore nuk kanë evidentuar asnjë shqetësim deri tani, të cilin nuk kanë mundur t'a dominojnë nevojat, interesat elektorale dhe mundësitë e subjekteve zgjedhore. Në diskutimet e reformave zgjedhore çështja ngelet e padebatuar, për pasojë nuk formon shqetësim të ligjvënësi, ndërkohë që shqetësimi i ligjzbatuesit (komplikon fletën e votimit, vështirëson dhe zgjat numërimin e votave) nuk zgjidhet dot duke lejuar Komisionerin që, jashtë tagrave të veta, të vendosë normë të re juridike.

7. Vendimi i Komisionerit nr.156 datë 17.3.2021 është akt administrativ me karakter individual. Si i tillë, ai nuk mund të caktojë rregulla lidhur me përmbajtjen e listave të kandidatëve. Ai duhet të zbatojë rregullat që normojnë përmbajtjen e listës. Pavarësisht nga kjo, me këtë vendim Komisioneri ka caktuar rregullin se "rregulli ... duhet të jetë i tillë që, në rastet kur numri i mandateve për çdo zonë zgjedhore... është i plotëpjesëtueshëm me numrin tre (3), atëherë nuk është e nevojshme shtesa në numrin e kandidatëve në listat shumëmemërore. Në rastet kur numri i mandateve për zonën zgjedhore nuk është i plotëpjesëtueshëm me numrin 3 (tre) i shtohet 1 (një) për ta bërë të plotëpjesëtueshëm me numrin tre (3) dhe në rast se sërish shumë është jo e plotëpjesëtueshme me numrin 3, atëherë i shtojmë 2". Ky formulim që përbën rregull (normë) përveçse është në kundërshtim me pikën 4 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor, është edhe jashtë kompetencës ligjore të Komisionerit. Ky rregull është vendosur nga Komisioneri a posteriori, me një nga aktet e fundit për regjistrimin e listave të zgjedhësve. Deri në datën e këtij vendimi, subjektet zgjedhore janë orientuar për formatimin e listave, sikurse pohoi përfaqësuesi i palës së interesuar, tek një postim në rrjetin social Tëitter të kryer nga Komisioneri, në të cilin jepeshin indikacione për numrin e kandidatëve në listën shumëmemërore për çdo parti apo koalicion, sipas qarqeve.

8. Komisioneri ka orientuar të gjitha subjektet zgjedhore tek numri total 153 i kandidatëve të listave për subjekt. Ky numër bie ndesh me kushtin e minimumit ligjor të listës në 8 nga 12 qarqe që ka vendi (Dibër, Durrës, Elbasan, Korçë Kukës, Shkodër, Tiranë, Vlorë). Nëse numrit të mandateve për çdo qark do t'i shtohesh shifra 2 dhe pastaj numrat do të rrumbullakoseshin nga lart për shkak të plotëpjesëtimit me 3, atëherë numri total i kandidatëve të listës për subjekt do të rezultonte 177. Ky numër formon shifrën më të ulët që është në përputhje si me kushtin e numrit minimal ligjor të listës, ashtu dhe me kushtin e plotëpjesëtueshmërisë me 3. Ky numër dhe numri 222 që ka aplikuar subjekti ankues për listën e tij janë njëlloj të ligjshëm.

9. K.A.S.-i e gjen të pamundur që të vendosë detyrimin për subjektin ankues që listat e tij të kandidatëve të ndalen në numrin 177 të totalit. KAS-i, sikurse dhe

Komisioneri, nuk ka tagrin të caktojë rregulla (të vendosë normë). Normën në kuadër të KQZ-së e vendos Rregullatori përpara se të lindë nevoja për zbatimin e saj. Vendosja e normës nga Komisioneri ose KAS-i nëpërmjet akteve zbatuese, jo vetëm që përbëjnë tejkalim kompetence, por edhe anashkalojnë procedurën e miratimit të normës dhe mohojnë të drejtën e ankimit të drejtpërdrejtë ndaj saj.

10. K.A.S.-i e sheh gjithashtu jashtë tagrave të veta urdhërimin që procesi i regjistrimit të riçelet për një afat të shkurtër për subjektet e tjera zgjedhore, të cilat kanë përfunduar procedurat e regjistrimit të listave shumemërore, duke iu bindur orientimit tek shifra 153 e totalit. KAS-i nuk mund të ndryshojë apo shfuqizojë vendime që kanë marrë formë të prerë, sikurse nuk mund të vendosë procedura dhe afate të reja.

11. Pala e interesuar ngriti pretendimin se mosankimimi i ankuesit ndaj vendimit të Komisionerit nr.131 datë 10.3.2021 prekludon ankimin ndaj vendimit të Komisionerit nr.156 datë 17.3.2021. K.A.S.-i çmon se mosankimimi ndaj vendimit të ndërmjetëm dhe ankimimi ndaj vendimit përfundimtar nuk formojnë kontradiktë në vetvete. E drejta e ankimit është çështje e vullnetit të palës dhe nuk lidhet me qëndrimin që pala mban përgjatë procedurës administrative, por lidhet me qëndrimin që ajo mban ndaj aktit.

12. Pala e interesuar ngriti pretendimin se pranimi i kërkesës ankimore krijon kushte pabarazie në garë, sa kohë që të gjitha subjektet kanë regjistruar lista me 153 kandidatë dhe vetëm ankuesi regjistron një listë me 222 kandidatë. K.A.S.-i vëren edhe një herë, se Kodi Zgjedhor nuk e përmban numrin fiks të listës së kandidatëve as si detyrim, as si kusht apo kriter ligjor. Edhe në zgjedhjet e mëparshme listat e subjekteve kanë qenë fleksibël, por ky fakt nuk është trajtuar nga asnjë palë si avantazh apo disavantazh i padrejtë. Kodi Zgjedhor mbështetet në lirinë e subjekteve zgjedhore për të formatuar listën e tyre të kandidatëve. Tek kjo liri qëndron barazia e palëve, në lirinë e tyre për të përcaktuar vetë numrin e kandidatëve në listë, për t'a përcaktuar atë në përputhje me nevojat si subjekt-parti apo subjekt-koalicion, në përputhje me fuqinë elektorale, me shtrirjen dhe organizimin në territor etj.

13. Megjithëse K.A.S.-i vendosi pranimin në shqyrtim të palës së interesuar, pas ngritjes së pretendimit prej saj se vendimi eventualisht mund t'i prekë të drejtat dhe interesat e saj të ligjshme, gjatë seancës pala e interesuar nuk ngriti asnjë pretendim dhe nuk parashtrroi asnjë kërkesë, zgjidhja e të cilave mund të ndikonte në përmbajtjen e listave të kandidateve të vetë palës së interesuar, si p.sh. kërkesë për të riçelur afatin e regjistrimit të listave edhe për subjektet e tjera, nëse ndryshohej Vendimi i Komisionerit nr.156 date 17.3.2021, apo vendosja e një

kufiri të ri të sipërm për të gjitha subjektet, i cili të respektonte më saktë kushtin për numrin minimal të kandidatëve për listë etj. Kërkesa të kësaj natyre do të përbënin shkak ligjor për të fituar statusin procedural të palës së interesuar. Në kushtet kur pala e interesuar nuk e shfrytëzoi statusin procedural të ofruar nga KAS me unanimitet, për të kërkuar apo rivendosur të drejta të lidhura me subjektin politik PS, përfitimi i statusit të palës së interesuar për të ndërhyre në një procedurë ligjore pa lidhje të drejtpërdrejte me interesat e veta, përbën keqperdorim të instrumentit procedural dhe cënon seriozitetin e procedurës administrative...”.

8. Partia Socialiste e Shqipërisë, pasi është bërë me dije me vendimin e K.A.S. duke pretenduar se ky vendim është i pabazuar në ligj dhe në prova i është drejtuar Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë me padinë objekt gjykimi.

9. Pala paditëse, Partia Socialiste e Shqipërisë në kërkesëpadi dhe gjatë gjykimit, nëpërmjet përfaqësuesve të saj, pretendoi se:

- Një nga parimet më të rëndësishme të fushatës zgjedhor është ai i barazisë së palëve në garë dhe K.A.S, duke lejuar njërin koalicion të garojë me më shumë kandidatë se të gjithë koalicionet apo subjektet e tjera, e ka shkelur këtë parim në mënyrë flagrante. Në çështjen konkrete, K.A.S ka patur si detyrë parësore vlerësimin e ligjit dhe frymën që ai përcjellë në tërësinë e tij dhe nuk duhej të interpretonte në mënyrë të ngushtë një fjalë apo fjali të dispozitës.
- Me vendimin nr.131 datë 10.03.2021, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve (K.Sh.Z) si organi kompetent për miratimin e listave shumëmemërore, ka vendosur kthimin për korrigjim të dokumentacionit të listës shumëmemërore të kandidatëve për deputetë të subjektit zgjedhor Koalicioni “Partia Demokratike-Aleanca për Ndryshim”. Koalicioni në fjalë jo vetëm që nuk e kundërshtoi këtë vendim, por përkundrazi depozitoi lista të tjera me një numër edhe më të lartë kandidatësh sesa ato në listën e parë.
- K.A.S në interpretimin e ligjit për kërkesën ankimore të Koalicionit PD-AN, nuk mund të kufizohet në interpretimin e “ngushtë literal” të fjalisë së dyte të pikës 4 të nenit 67, por duhet të lexohet neni dhe Kodi në tërësi, duke patur në konsideratë parimin e proporcionalitetit në zbatimin e ligjit dhe përmbushjen e detyrimit kushtetues për të zhvilluar zgjedhje të lira, të barabarta, të përgjithshme periodike!
- Neni 67 pika 4 e Kodit Zgjedhor përcakton se “Numri i kandidatëve në listën shumëmemërore nuk mund të jetë më i vogël se numri i mandateve që do të zgjidhen në zonën zgjedhore përkatëse, shtuar dy. Në çdo rast, numri i

kandidatëve në listën shumemërore duhet të jetë i plotpjesëtueshëm me numrin tre”.

- Në përputhje me parashikimet e nenit 64 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Kuvendi përbëhet nga 140 deputet (mandate). Sipas nenit 67 pika 4 e Kodit Zgjedhor më sipër cituar, është një përcaktim që nuk tregon numrin minimal të kandidatëve në listën shumemërore, por tregon sesa është ky numër. Është detyrim për partitë politike që numri i kandidatëve në listën shumemërore nuk mund të jetë më i vogël se numri i mandateve që do të zgjidhen në atë zonë. Shprehja “shtuar dy” lë vend për interpretim. Interpretimi, lind pasi togfjalëshi “në çdo rast” që fillon fjalia vijuese, lë të kuptohet se situata e parashikuar në rregullin e parashikuar nga fjalia e parë nuk mund të jetë vetëm një (pra, numri i mandateve në zonë, plus dy), por lë të kuptohet se mund të ketë më shumë se 1 (një) që mund të jetë ose jo i plotpjesëtueshëm me numrin 3 (tre). Për të kapërcyer situata të tilla, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka çmuar se, rregulli vijues pas rregullit në pikën 1, për zbatimin e nenit 67, pika 4, duhet të jetë i tillë që, në rastet kur numri i mandateve për çdo zonë zgjedhore, të përcaktuar me vendimin e KRR cituar më sipër, është i plotpjesëtueshëm me numrin tre (3), atëherë nuk është e nevojshme shtesa në numrin e kandidatëve në listat shumemërore. Në rastet kur numri i mandateve për zonën zgjedhore nuk është i plotpjesëtueshëm me numrin 3 (tre) i shtohet 1 (një) për ta bërë të plotpjesëtueshëm me numrin tre (3) dhe në rast se sërish shuma është jo e plotpjesëtueshme me numrin 3, atëherë i shtojmë 2. Në këtë mënyrë, respektohet edhe limiti prej 2 mandatesh shtesë që ka parashikuar dispozita dhe në të njëjtën kohë bëhet e zbatueshme.
- Neni 67, pika 4 i Kodit Zgjedhor përcakton ekzaktësisht sa do të jetë numri i kandidatëve për deputetë dhe nuk përcakton numrin minimal, sepse përndryshe do të duhej që ligjvënësi të kishte përcaktuar edhe se sa do të ishte numri maksimal ose do të duhej t’ia kishte lënë këtë kompetencë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Por kjo dispozitë mungon. Sa më sipër është një argument logjik për të theksuar edhe njëherë se është pikërisht parashikimi i nenit 67, pika 4 që përcakton numrin e kandidatëve për deputetë në listat shumemërore të subjekteve zgjedhore.
- Numri i kandidatëve që duhet të përmbajë lista është përcaktuar në Urdhërin e botuar nga Kryekomisioneri në faqen zyrtare të Twiter me datën 08.03.2021. Në këtë kuptim koalicioni nuk i është përmbajtur urdhrave ligjor të K.Q.Z
- Në këtë kuptim, vlerësimi i K.SH.Z se “...numri i kandidatëve i listës shumemërore të Koalicionit PD-AN nuk është në përputhje me përcaktimet e Kodit Zgjedhor...” është i drejtë dhe në interpretim të saktë të normës së Kodit Zgjedhor.

- Vlerësimi nga K.A.S se K.SH.Z ka marrë një vendim përtej tagrave ligjor, për të korrigjuar listën është i pabazuar në ligj dhe në prova, pasi nga arsyetimi i vendimit objekt ankimi, kuptohet mjaft qartë që konkludimi i K.SH.Z ka qënë rrjedhojë logjike e interpretimit të normës ligjore. Neni 67/4 i Kodit Zgjedhor ka parashikuar formulën mbi bazën së cilës duhet të paraqitet numri i kandidatëve. Këtu është rasti të përmendim edhe faktin se subjektet zgjedhore nuk duhet të abuzojnë në këtë mënyrë me mangësitë procedurale jo edhe aq të vështira si kjo që po shqyrtohet.
- Po ashtu edhe qëndrimi i K.A.S. se subjekti zgjedhor Partia Socialiste “nuk parashit asnjë kërkesë, zgjidhja e të cilave mund të ndikonte në përmbajtjen e listave të kandidatëve të vetë palës së interesuar, si p.sh. kërkesë për të riçelur afatin e regjistrimit të listave edhe për subjektet e tjera, nëse ndryshohej Vendimi i Komisionerit nr.156 datë 17.3.2021, apo vendosja e një kufiri të ri të sipërm për të gjitha subjektet, i cili të respektonte më saktë kushtin për numrin minimal të kandidatëve për listë etj. “është haptazi abuziv dhe pa logjikë ligjore”. Partia Socialiste në zbatim të dizpozitave të Kodit Zgjedhor ka depozituar lista të rregullta me numër të saktë të kandidatëve dhe e kundërshton listën e koalicionit pasi bie ndesh me ligjin. Në këtë kuptim, ky subjekt nuk mund të kërkonte që të çelej rruga për të vijuar me kundraligjshmërinë edhe vetë si subjekt zgjedhor.
- Gjithashtu, është i papranueshëm arsyetimi i K.A.S se “Në zgjedhjet e vitit 2017 p.sh. ankuesi e ka caktuar kufirin e sipërm për qarkun e Tiranës në shifrën 50 nga 34 mandate, për qarkun e Durrësit në 19 nga 12 mandate, për Elbasanin në 20 nga 14 mandate, për Gjirokastrën në 9 nga 5 mandate etj.. Kjo liri veprimi në vitin 2017 as është kontestuar dhe as është vënë në dyshim.” (faqe 7, pika 4 e vendimit). Nuk ka qënë në atë kohë, por sot është, dhe nuk mjafton një arsyetim i tillë pa asnjë referencë ligjore. Legjislacioni ka ndryshuar, po ashtu kanë ndryshuar edhe interesat elektorale te subjekteve zgjedhore. Aktualisht jemi me lista te hapura dhe në atë kohe nuk ishte ky rregullim ligjor.
- Sipas K.A.S, lista është fleksibël sa kohë që numri i kandidatëve në listë varet nga nevojat, interesat elektorale dhe mundësitë e vetë subjektit, por jo infinit dhe se ligjvënësi, me ndërhyrjet e herëpashërëshme, nuk ka preferuar t’i vendosë listës kufi të sipërm. Edhe ky arsyetim është i papranueshëm, për faktin se nevojat e secilit subjekt zgjedhor, kur merr pjesë në garë, nuk mund të kenë liri plotësimi të tyre, pasi referimi për këtë duhet të behet në ligjin zgjedhor dhe zbatimin e tij edhe prej subjekteve të tjera. Të gjitha subjektet zgjedhore i janë përmbajtur në mënyrë strikte interpretimit dhe frymës që përcjellë ligji zgjedhor duke depozituar numër të rregullt kandidatës dhe pa shtesa.

- K.A.S ka arsyetuar se minimumi i kandidatëve në çdo zonë është numri i mandateve shtuar 2, duke i shtuar përsëri 1-2 për efekt të plotpjesëtimit me 3, duke përcaktuar si kufi minimal ligjor të listës për 12 qarqet, numrin total prej 177 kandidatësh. (psh në qarkun Dibër me 6 mandate do të shtohen 3 (2+1) candidate, ndërsa në Korçë me 11 do shtohen 4 të tilla (2+2). Është e paqartë se nga buron ky “rregull”, po nëse do pranohej ky interpretim në rrethanat aktuale, listat që kanë depozituar 11 subjektet e tjera zgjedhore , që kanë pranuar vendimin e K.SH.Z. për numrin prej 153 kandidatësh, përveçse i vendos në kushte të pabarabarta gare, gjithashtu të gjithë subjektet e tjera, janë në kundërshtim me ligjin. K.SH.Z e ka analizuar situatën e sipërcituar, (faqe 11 vendimit), dhe ka konkluduar se aplikimi i rregullimit të pretenduar nga shumica (numri i mandateve shtuar 2), gjithashtu nuk plotësonte kriteret ligjore në mënyrë kumulative dhe për këtë shkak ishte i pa aplikueshëm.
- Në këtë kuptim, K.SH.Z me vendimin Nr. 156, datë 17.03.2021 ka interpretuar drejt dhe saktë normën. Në të njëjtën kohë, ankuesi nuk ka dhënë asnjë argument se pse dhe si vendimi objekt ankimi e cënon interesin zgjedhor të tij.
- Për sa më sipër, në bazë të nenit 3, pika 2, neni 67, neni 98, pika 4, 145, neni 158, pika 1, germa “b” të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 Kodit Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, i përditësuar, pala paditëse, Partia Socialiste e Shqipërisë kërkoi ndryshimin e vendimit Nr.9 datë 23.03.2021 të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve dhe lënien në fuqi të vendimit Nr.156 datë 17.03.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

10. Pala e paditur, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, nëpërmjet përfaqësuesve të tij, gjatë gjykimit pretendoi se:

- Neni 67 pika 4 e Kodit Zgjedhor përcakton se “Numri i kandidatëve në listën shumëemërore nuk mund të jetë më i vogël se numri i mandateve që do të zgjidhen në zonën zgjedhore përkatëse, shtuar dy. Në çdo rast, numri i kandidatëve në listën shumëemërore duhet të jetë i plotpjesëtueshëm me numrin tre”.
- Në përputhje me parashikimet e nenit 64 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Kuvendi përbëhet nga 140 deputet (mandate).
- Komisioni Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, me vendimin nr.7, datë 11 dhjetor 2020 ka përcaktuar numrin e mandateve për çdo zonë zgjedhore për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021, si vijon: Berat 7, Dibër 5, Durrës 14, Elbasan 14, Gjirokastër 4, Fier 16, Korçë 11, Kukës 3, Lezhë 7, Shkodër 11, Tiranë 36, Vlorë 12, në total 140 deputetë.
- Sa parashikon neni 67 pika 4 e Kodit Zgjedhor më sipër cituar, është një përcaktim që nuk tregon numrin minimal të kandidatëve në listën

shumëmërore, por tregon sesa është ky numër. Është detyrim për partitë politike që numri i kandidatëve në listën shumëmërore nuk mund të jetë më i vogël se numri i mandateve që do të zgjidhen në atë zonë. Interpretimi që i bëhet dispozitës së të kuptohet se situata e parashikuar në rregullin e parashikuar nga fjalë e parë nuk mund të jetë vetëm një (pra, numri i mandateve në zonë, plus dy), por të kuptohet se mund të ketë më shumë se 1 (një) që mund të jetë ose jo i plotëpjesëtueshëm me numrin 3 (tre). Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve çmon se, rregulli vijues pas rregullit në pikën 1, për zbatimin e nenit 67, pika 4, duhet të jetë i tillë që, në rastet kur numri i mandateve për çdo zonë zgjedhore, të përcaktuar me vendimin e KRR cituar më sipër, është i plotëpjesëtueshëm me numrin tre (3), atëherë nuk është e nevojshme shtesa në numrin e kandidatëve në listat shumëmërore. Në rastet kur numri i mandateve për zonën zgjedhore nuk është i plotëpjesëtueshëm me numrin 3 (tre) i shtohet 1 (një) për ta bërë të plotëpjesëtueshëm me numrin tre (3) dhe në rast se sërish shuma është jo e plotëpjesëtueshme me numrin 3, atëherë i shtojmë 2. Në këtë mënyrë, respektohet edhe limiti prej 2 mandatesh shtesë që ka parashikuar dispozita dhe në të njëjtën kohë bëhet e zbatueshme.

- Më tej, vlerësoj se, ndonëse numri i kandidatëve i listës shumëmërore nuk është në përputhje me përcaktimet e Kodit Zgjedhor, nuk jemi në kushtet ligjore të refuzimit të listës të parashikuara në nenin 67 pika 7 e Kodit Zgjedhor ku parashikohet se: “Në rast mospërmbyshjeje të njërit prej kushteve të parashikuara në këtë nen, në lidhje me përbërjen e listës shumëmërore KQZ-ja zbaton sanksionet e parashikuara në nenin 175 të Kodit Zgjedhor”. Neni 175 i Kodit Zgjedhor parashikon sanksionin për mosrespektim të barazisë gjinore si vijon: “mospërmbyshja nga subjekti zgjedhor i detyrimit të parashikuar në pikën 6 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor passjell refuzimin e listës shumëmërore për t’u regjistruar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve”.
- Do të ishim përpara shkaqeve për refuzimin e listës nëse nuk do të ishte respektuar kuota gjinore. Dhe ky nuk është rasti, pasi subjekti zgjedhor e ka respektuar kuotën gjinore. Do të përbënte shkak për refuzim të listës nëse nuk do të kishim një listë kandidatësh për çdo qark, gjë që ky koalicion e ka respektuar, ne kemi listën për çdo qark, dhe nëse numri i kandidatëve nuk do të ishte aq sa kërkon Kodi Zgjedhor. Në rastin konkret kemi një numër më të madh kandidatësh sesa kërkon Kodi Zgjedhor, kështu që, në këto rrethana nuk jemi në kushtet ligjore për të refuzuar listën. Përsa më sipër, pala e paditur Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, nëpërmjet përfaqësuesve të tij e la në çmim të gjykatës zgjidhjen e mosmarrëveshjes.

11. Pala e interesuar në këtë gjykim, Koalicioni “Partia Demokratike-Aleanca për Ndryshim(PD-PR-PDIU-PAA-PBDNJ-PDK-LZHK-PLL-FRD-BLD-PBKD-PBD-PKD) “PD-AN”, nëpërmjet përfaqësuesit të tij, gjatë gjyimit pretendoi se:

- Në datën 10.03.2021 me anë të vendimmarrjes nr.131 Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka disponuar për kthimin e listave shumemërore për plotësim, Koalicionit "Partia Demokratike- Aleanca për Ndryshim" subjekt ky i regjistruar rregullisht për zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 Prill 2021
- Arsyet e kthimit për plotësim kanë qënë disa parregullsi të aspektit proceduralo- formal të dokumentacionit të paraqitur, dhe brenda tagrave të verifikimit të K.Q.Z. nëpërmjet Komisionerit, sipas neneve 72 dhe 73 të Kodit Zgjedhor.
- Pavarësisht kësaj, K.SH.Z. ka konstatuar në mënyrë të gabuar, mospërputhje të listës shumemërore të Kolicionit, në qarqe të ndryshëm, me parashikimet e nenit 67/4 të Kodit Zgjedhor. Konkretisht K.SH.Z. ka konstatuar se numri i kandidatëve në listat shumemërore të koalicionit, në qarqe të caktuara, vjen në tejkalim të numrit të kandidatëve të lejuar sipas nenit 67 pika 4 i Kodit Zgjedhor. Ky konstatim është i gabuar, dhe jo në përputhje me parashikimet e dispozitës, pasi dispozita përmban kufi minimal të pranueshëm të listës shumemërore të kandidatëve dhe jo një kufi maksimal.
- Vendimmarrja e K.Q.Z. e datës 10.03.2021, me anë të së cilës kthen për plotësim listat e koalicionit PD-Aleanca për ndryshim, për korrigjim, pasi numri i kandidatëve të paraqitur është më i lartë se ai i lejuar nga ligji, vjen në kundërshtim me parashikimet e nenit 67, pika 4 të Kodit Zgjedhor. Qartësisht dispozita parashikon numër minimal kandidaturash që duhet të përmbajë lista shumëemërore, por në asnjë rrjesht të dispozitës nuk përmbahet ndonjë parashikim lidhur me një numër maksimal kandidatësh që duhet të përmbajë lista.
- Qartësisht vullneti i legjislatorit ka qënë të kodifikojë rregullin që:
 1. numri minimal i kandidaturave duhet të jetë i barabartë me numrin e mandateve në atë zonë zgjedhore shtuar dy (kufiri minimal)
 2. çdo numër i njëjtë ose më i madh se kufiri minimal- mjafton që të jetë i plotpjesëtueshëm me 3 (kufiri maksimal)
- Ky është jo vetëm qëndrimi dhe interpretimi ynë lidhur me leximin e pikës 4 të nenit 67, por leximi dhe interpretimi i vetëm në përputhje me vullnetin e legjislatorit në kodifikimin e këtij rregulli. Pretendohet se parashikimi i legjislatorit në formulimin e nenit 67, pika 4 në ndryshimet e fundit të Kodit Zgjedhor, vjen në një linjë me parashikimet dhe formulimet e mëparshme të kësaj dispozitë të cilat nuk parashikonin kufi maksimal kandidatësh në listat shumëemërore por vetëm kufi minimal.
- Ndryshimet e vetme që i janë bërë dispozitës, janë ato lidhur me detyrimin e subjekteve që numrin e kandidaturave që do ta shohin të përshtatshme të

depozitojnë duhet t'a kenë të plotpjesëtueshëm me 3, në mënyrë që të ruhet kuota gjinore. Ky rregull sigurisht që duhet të aplikohet në harmoni të plotë edhe me rregulla të tjerë në kodin zgjedhor, të cilat janë të ndërlidhura me dispozitën e sipërcituar dhe të cilat afektojnë drejtpërsëdrejti pasqyrimin e kandidaturave të koalicionit në fletën e votimit.

- Dispozita në leximin dhe aplikimin e saj nuk mund të shërbejë si instrument për të bërë të pa aplikueshme dispozita të tjera të po atij ligji, madje të pengojë edhe të drejta të garantuara në Kushtetutë edhe Kod, si për shembull ato të partive të asociuara në një koalicion me një listë të përbërë, që të mund të garantojë me të paktën një përfaqësues në listën e koalicionit në çdo zonë zgjedhore. Kjo pamundësohet me interpretimin shtrëngues të nenit 67, të bërë nga KQZ, veçanërisht në qarqe me numra të vegël mandatesh.
- Përfundimisht, nga pala e interesuar Koalicioni “Partia Demokratike-Aleanca për Ndryshim (PD-PR-PDIU-PAA-PBDNJ-PDK-LZHK-PLL-FRD-BLD-PBKD-PBD-PKD) “PD-AN”, nëpërmjet përfaqësuesit të tij kërko rrëzimin e kërkesëpadisë së paditësit, Partia Socialiste dhe lënien në fuqi të vendimit nr.9 datë 23.03.2021 të K.A.S.

12. Gjykata pasi analizoi dispozitat ligjore, administroi provat shkresore dhe dëgjoi pretendimet e palëve, çmon se padia me paditës Partia Socialiste e Shqipërisë, është e mbështetur në prova dhe në ligj dhe duhet të pranohet.

13. Në nenin 67 pika 4 e Kodit Zgjedhor është përcaktuar se “*Numri i kandidatëve në listën shumemërore nuk mund të jetë më i vogël se numri i mandateve që do të zgjidhen në zonën zgjedhore përkatëse, shtuar dy. Në çdo rast, numri i kandidatëve në listën shumemërore duhet të jetë i plotpjesëtueshëm me numrin tre*”.

14. Në përputhje me parashikimet e nenit 64 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Kuvendi përbëhet nga 140 deputet (mandate). Komisioni Rregullator (K.RR) në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, me vendimin nr.7, datë 11 dhjetor 2020 ka përcatuar numrin e mandateve për çdo zonë zgjedhore për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021, si vijon: Berat 7, Dibër 5, Durrës 14, Elbasan 14, Gjirokastër 4, Fier 16, Korçë 11, Kukës 3, Lezhë 7, Shkodër 11, Tiranë 36, Vlorë 12, në total 140 deputetë.

15. Në interpretim të nenit 67 pika 4 e Kodit Zgjedhor, gjykata çmon se është një përcaktim që nuk tregon numrin minimal të kandidatëve në listën shumemërore, por tregon sesa është ky numër. Në kuptim të përmbajtjes së kësaj

prike të Kodit Zgjedhor, ky numër i kandidatëve në listën shumemërore përcaktohet nga tre elementë që janë:

1. Numrin e mandateve në zonën zgjedhore
2. Numrin 2 (dy), (pra shtuar 2 (dy));
- 3- Plotëpjesëtimin me numrin 3 (për respektimin e kuotës gjinore.

16. Është detyrim për partitë politike që numri i kandidatëve në listën shumemërore nuk mund të jetë më i vogël se numri i mandateve që do të zgjidhen në atë zonë (kriteri i parë). Shprehja “shtuar dy” lë vend për interpretim. Interpretimi lind pasi togfjalëshi “në çdo rast” që fillon fjalia vijuese, lë të kuptohet se situata e parashikuar në rregullin e parashikuar nga fjalia e parë nuk mund të jetë vetëm një (pra, numri i mandateve në zonë, plus dy), por lë të kuptohet se mund të ketë më shumë se 1 (një) që mund të jetë ose jo i plotëpjesëtueshëm me numrin 3 (tre). Në interpretim të kësaj dispozite, gjykata çmon se, kriteri vijues pas kriterit të parë, për zbatimin e nenit 67, pika 4, duhet të jetë i tillë që, në rastet kur numri i mandateve për çdo zonë zgjedhore, të përcaktuar me vendimin e K.RR. cituar më sipër, është i plotëpjesëtueshëm me numrin tre (3), atëherë nuk është e nevojshme shtesa në numrin e kandidatëve në listat shumemërore. Në rastet kur numri i mandateve për zonën zgjedhore nuk është i plotëpjesëtueshëm me numrin 3 (tre) i shtohet 1 (një) për ta bërë të plotëpjesëtueshëm me numrin tre (3) dhe në rast se sërish shumë është jo e plotëpjesëtueshme me numrin 3, atëherë i shtohet 2. Në këtë mënyrë, respektohet edhe limiti prej 2 mandatesh shtesë që ka parashikuar dispozita dhe në të njëjtën kohë ajo bëhet e zbatueshme.

17. Është e qartë se dispozita në fjalë (neni 67, pika 4 i Kodit Zgjedhor) përcakton numrin e kandidatëve për deputetë në listat shumemërore të paraqitura në KQZ. Dispozita përcakton ekzaktësisht sa do të jetë numri i kandidatëve për deputetë dhe nuk përcakton numrin minimal, sepse përndryshe do të duhej që ligjvënësi të kishte përcaktuar edhe se sa do të ishte numri maksimal ose do të duhej t’ia kishte lënë këtë kompetencë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Por kjo dispozitë mungon. Sa më sipër, është një argument logjik për të theksuar edhe njëherë se është pikërisht parashikimi i nenit 67, pika 4 që përcakton numrin e kandidatëve për deputetë në listat shumemërore të subjekteve zgjedhore.

18. Themeli i normës juridike është të vendosë kufirin e sipërm të listës, pasi kufiri i poshtëm është sa numri i mandateve. Kufiri i sipërm i listës së kandidatëve është numri më i afërt i plotëpjesëtueshëm me 3 i numrit të mandateve, duke i shtuar deri në 2 (dy) kandidatë. Infiniti nuk është ratio i normës.

19. Në këto kushte, gjykata çmon se pretendimi i personit të interesuar Koalicioni “Partia Demokratike-Aleanca për Ndryshim”, se nenit 67, pika 4 i Kodit

Zgjedhor, parashikon numrin minimal të kandidaturave që duhet të përmbajë lista shumëmemërore, por në asnjë rresht të dispozitës nuk përmbahet ndonjë parashikim lidhur me një numër maksimal kandidatësh që duhet të përmbajë lista, nuk qëndron. Numri i lartë i listës së kandidateve do të sillte problematikë thelbësore në fletën e votimit. Hartimi i listave shumëmemërore pa përcaktuar një numër fikse kandidatësh, do të sillte vështirësi dhe pamundësi fizike në hartimin e fletëve të votimit, duke i ngarkuar ato dhe duke vështirësuar procesin e votimit për zgjedhësit, pra duke rënë ndesh me parashikimet e nenit 98, pika 4 të Kodit Zgjedhor, që thekson se “Fleta e votimit për zgjedhjet për Kuvendin duhet të përmbajë hapësirën e posaçme për ushtrimin e votimit parapëlqyes për kandidatët e subjektit zgjedhor. Mënyra e votimit parapëlqyes përcaktohet nga KQZ-ja në varësi nga numri i subjekteve pjesëmarrëse në zgjedhje, duke respektuar kushtin që informacioni i përcjellë nga fleta e votimit të mos jetë tejet i ngarkuar, konfigurimi i fletës të jetë i qartë e i kuptueshëm për zgjedhësin dhe zgjedhësi ta ketë të lehtë orientimin për votimin e subjektit zgjedhor dhe të kandidatit të parapëlqyer”.

21. Gjithashtu gjykata çmon se pretendimi tjetër i personit të interesuar, i pranuar edhe nga K.A.S. se “parashikimi i legjislatorit në formulimin e nenit 67 pika 4 në ndryshimet e fundit të Kodit Zgjedhor, vjen në një linjë me parashikimet dhe formulimet e mëparshme të kësaj dispozite”, nuk qëndron. Me ndryshimet e fundit të bëra në Kodin Zgjedhor me ligjin nr.118 datë 05.10.2020 janë vendosur kritere të qarta për të përcaktuar një numër ekzakt për kandidatët e listave shumëmemërore, në ndryshim nga dispozita e mëparshme, e cila përcaktonte vetëm se “Numri i kandidatëve në listën shumëmemërore të një partie të regjistruar si subjekt zgjedhor më vete apo numri i përgjithshëm i kandidatëve të një koalicioni nuk duhet të jetë më i vogël sesa numri i mandateve që do të zgjidhen në zonën zgjedhore përkatëse”. Ky rregullim i ndryshëm ligjor, determinohet nga modeli që sjell Kodi Zgjedhor me listat e hapura dhe votimin e kandidatit të parapëlqyer, që sjell, si pasojë një listë të “mbyllur” nga pikëpamja e numrit të kandidatëve, në ndryshim nga “listat e hapura” në kushtet kur votohej vetëm subjekti zgjedhor dhe jo kandidati.

22. Gjykata thekson se arsyetimi i dhënë nga K.A.S, në vendimin e tij, se lista është fleksibël për sa kohë që numri i kandidatëve në listë varet nga nevojat, interesat elektorale dhe mundësitë e vetë subjektit, por jo infinit dhe se ligjvënësi, me ndërhyrjet e herëpashërëshme, nuk ka preferuar t’i vendosë listës kufi të sipërm, nuk qëndron. Kjo, për faktin se nevojat e secilit subjekt zgjedhor, kur merr pjesë në garë plotësohen në përputhje me ligjin zgjedhor, i cili gjen njësoj zbatim edhe prej subjekteve të tjera zgjedhore. Të gjitha subjektet zgjedhore duhet t’i përmbahen në mënyrë strikte interpretimit dhe frymës që përcjellë ligji zgjedhor duke depozituar numër të rregullt kandidatësh dhe pa shtesa.

23. Për sa më sipër, gjykata çmon se kërkesë-padia me paditës Partia Socialiste e Shqipërisë, është e mbështetur në prova dhe në ligj dhe duhet të pranohet.

PËR KËTO ARSYE

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor, bazuar në Ligjin nr.10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i përditësuar,

V E N D O S I

- Pranimin e padisë.
- Shfuqizimin e vendimit nr.9 datë 23.03.2021 të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve dhe lënien në fuqi të vendimit nr.156 datë 17.03.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.
- Ky vendim është i formës së prerë dhe ndaj tij nuk lejohet ankim.
- U shpall në Tiranë, sot më datë 29.03.2021.

GJYQTARE
Manjola XHAXHO

GJYQTARE
Esmeralda XHILI

GJYQTARE
Alma KOLGJOKA

GJYQTAR
Asim VOKSHI
(kundër)

GJYQTAR
Gentian MEDJA

MENDIM PAKICE

(i gjyqtarit Asim VOKSHI)

1. Në çështjen administrative-zgjedhore me nr.3.regj.them, nr.3.vendimi, datë: 29.03.2021, shqyrtuar nga Kolegji Zgjedhor Gjyqësor i mbledhur në sallën “Amfiteatri”, në selinë e Këshillit të Lartë Gjyqësor, me adresë: Godina Poli i Drejtësisë, Rr. “Ana Komnena”, Tiranë, e që i përket:

Paditëse: Partia Socialiste e Shqipërisë
I paditur: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
P/interesuar: Koalicioni “Partia Demokratike-Aleanca për Ndryshim (PD-PR-PDIU-PAA-PBDNJ-PDK-LZHK-PLL-FRD-BLD-PBKD-PBD-PKD) “PD-AN”.
Objekti: Ndryshimin e vendimit nr.9 datë 23.03.2021 të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve (K.S.A) dhe lënien në fuqi të vendimit nr.156, datë 17.03.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve (K.ZH.Z).
Baza ligjore: Neni 3, pika 2, neni 67, neni 98, pika 4, neni 145, neni 158, pika 1, germa “b”, të Kodit Zgjedhor, i përditësuar.

2. Në seancën gjyqësore të datës 29.03.2021, shumica me vendim përfundimtar vendosi:

“- *Pranimin e padisë.*

- *Shfuqizimin e vendimit nr.9, datë: 23.03.2021 të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve dhe lënien në fuqi të vendimit nr.156, datë: 17.03.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.”*

3. Duke qenë kundër vendimmarrjes së mësipërme të shumicës së trupit gjykues, çmoj të parashtoj përmbledhtazi në vijim arsyet në të cilat mbështes mendimin tim të mbetur në pakicë.

4. Pakica vlerëson se Kolegji Zgjedhor Gjyqësor (shumica) u bashkua me një lexim të gabuar të nenit 67(4) të Kodit Zgjedhor, të bërë më parë nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, i cili passjell vënien në paligjshmëri jo vetëm të listave të personit të interesuar (i cili duhej të ishte thirrur si i paditur) PD-AN, por edhe të vetë paditësit Partia Socialiste e Shqipërisë. Vlerësoj se është i bazuar pretendimi i paditësit PS se i janë cenuar interesat e veta të ligjshme, porse kjo nuk është bërë nga listat e PD-AN, por nga ana e orientimeve të paligjshme të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, i cili në kundërshtim me kriteret ligjore dhe në kapërcim të tagrave të veta i ka vendosur listat e PS (dhe subjekteve të tjera zgjedhore që garojnë me lista) nën minimumin e parashikuar nga fjalia e dytë e nenit 67(4) të Kodit Zgjedhor.

5. Pakica vlerëson se në rastet kur ligji është i qartë në kuptimin literal të tij, ai është kuptimi që duhet të gjejë zbatim. Konkretisht neni 67(4) i Kodit Zgjedhor përbëhet nga katër fjali, të cilat përcaktojnë katër rregulla të ndryshme dhe parashikon shprehimisht se:

“4. Emrat në listën shumemërore të subjektit zgjedhor paraqiten të renditura sipas rendit shifror, duke filluar nga numri një. Numri i kandidatëve në listën shumemërore nuk mund të jetë më i vogël se numri i mandateve që do të zgjidhen në zonën zgjedhore përkatëse, shtuar dy. Në çdo rast, numri i kandidatëve në listën shumemërore duhet të jetë i plotpjesëtueshëm me numrin tre. Për koalicionet përbri emrit të kandidatit shënohet cilës parti i përket kandidati.”

6. Nëse i ndajmë veç e veç katër fjalitë e kësaj dispozite, shohim se ato vërtetë synojnë të rregullojnë katër aspekte të veçanta të formaliteteve të listave të kandidatëve për deputetë, si vijon:

I) *Emrat në listën shumemërore të subjektit zgjedhor paraqiten të renditura sipas rendit shifror, duke filluar nga numri një. Këtu vendoset rregulli që lidhet me renditjen e kandidatëve në listat e subjekteve politike dhe është mjaft i qartë.*

II) *Numri i kandidatëve në listën shumemërore nuk mund të jetë më i vogël se numri i mandateve që do të zgjidhen në zonën zgjedhore përkatëse, shtuar dy. Këtu vendoset standardi minimal që duhet të respektohet nga subjektet zgjedhore, në lidhje me numrin e kandidatëve, të cilët në çdo rast do të jenë aq sa ka zona zgjedhore përkatëse, shtuar 2. Pra kjo është një shifër fikse, e cila nëse analizohet në rang kombëtar është në vlerën 164 kandidatë minimalisht që duhen propozuar nga subjektet politike (140 mandate deputeti + 24 kandidatë shtesë, në respekt të shprehjes “shtuar 2” = 164 kandidatë). Duke qenë se numri i mandateve për çdo zonë zgjedhore nuk është i paracaktuar por përcaktohet nga Komisioni Rregulator pranë KQZ bazuar në popullsinë që jeton në ato zona, ligjvënësi është treguar i kujdesshëm që të mos përcaktojë numra fiks kandidatësh në listat për deputetë, por ka dhënë vetëm standardet bazë për llogaritjen e tyre (duke përdorur jo pa qëllim shprehjen “nuk mund të jetë më i vogël se”). Këtë e ka bërë edhe për faktin se siç do të shohim edhe më poshtë, numri i kandidatëve, për shkak të përqindjeve gjinore të detyrueshme, duhet në çdo rast të plotpjesëtohet me tre. Ratio e ligjvënësit në këtë rast, siç del qartë edhe nga gjuha e përdorur, është që numri i kandidatëve të mos jetë asnjëherë më i vogël se numri i vendeve për të cilat kandidohet për deputet, plus 2 kandidatë më tepër (ligji nuk thotë shtuar 0 apo shtuar 1 apo shtuar deri në 2, por qartësisht thotë shtuar 2 dhe vetëm 2, për efekt në numrit minimal). Kjo është bërë me qëllim që të sigurohet minimumi i funksionimit të një liste zgjedhore, e të paraprihet mundësia e shterimit të listës për shkaqe objektive të pavarura nga subjektet zgjedhore (si p.sh: një kandidat për deputet mund të humbasë zotësinë juridike pas miratimit të listave, mund të caktohet në një pozicion që nuk pajtohet me mandatin e deputetit, etj), duke e lënë Kuvendin potencialisht me numër të cunguar deputetësh.*

III) *Në çdo rast, numri i kandidatëve në listën shumemërore duhet të jetë i plotpjesëtueshëm me numrin tre. Ky rregull, merr të mirëqenë faktin se pas zbatimit të fjalisë pararendëse të nenit 67(4) të Kodit Zgjedhor, mund të ndodhë që lista e deputetëve të mos jetë e plotpjesëtueshme me*

3 dhe synon ta korrektojë këtë situatë. Kjo lidhet me zbatimin e fjalisë së fundit të nenit 64(3) të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, sipas të cilës “[l]igji për zgjedhjet garanton që votimit parapëlqyes t’i nënshtrohen jo më pak se dy të tretat e listës shumemërore dhe të sigurojë *përfaqësim gjinor*.” Po ashtu është në funksion edhe të zbatimit të neneve 4, 67(5)(6) e 175 të Kodit Zgjedhor. Ky rregull qëndron më vete nga rregulli pararendës që përcakton numrin minimal të listave shumemërore dhe e ndikon atë, në kuptimin që lista mund të përmbajë edhe më shumë kandidatë sa është minimumi, nëse në kuptim të nenit 67(6) të Kodit Zgjedhor, nuk arrihet dot të sigurohet që “[p]ër çdo zonë zgjedhore në zgjedhjet për Kuvendin jo më pak se një në çdo tre emra të listës shumemërore duhet t’i përkasë gjinisë së nënpërfaqësuar”. Kjo pasi, në zbatim të nenit 175 të Kodit Zgjedhor sa i përket kuotave gjinore “[m]ospërmbushja nga subjekti zgjedhor i detyrimit të parashikuar në pikën 6 të nenit 67 të këtij ligji passjell refuzimin e listës shumemërore për t’u regjistruar në KQZ ose, sipas rastit, për zgjedhjet vendore në KZAZ.”

Në lidhje me sa më sipër, p.sh: në rastin e Kukësit, në zbatim të fjalisë së dytë të nenit 67(4) të Kodit Zgjedhor, numri minimal i kandidatëve do të ishte $3+2=5$ kandidatë, por meqë numri 5 nuk është i plotpjesëtueshëm me 3, atëherë në zbatim të neneve 4, 67(5)(6) e 175 të Kodit Zgjedhor, lista do të korrektohet duke u shtuar minimalisht edhe 1 kandidat e duke u paraqitur me 6 kandidatë për deputetë, nga të cilët të paktën 2 duhet të jenë të gjinisë femërore. Pra rregulli i vendosur në fjalinë e tretë të nenit 67(4) të Kodit Zgjedhor korrekton rregullin e vendosur nga fjalia pararendëse, por jo në sensin negativ (*duke u cenuar shprehja “shtuar 2”*) siç e ka lexuar Komisioneri dhe siç e lexoi edhe shumica e Kolegjit Zgjedhor, por në sensin pozitiv, duke u respektuar shprehja e ligjvënësit “shtuar 2”, e duke u shtuar eventualisht edhe aq kandidatë sa do të jetë e nevojshme për të realizuar përpjestueshmërinë me tre.

Vlen të theksohet gjithashtu se në këtë rregull ligjvënësi nuk ka vendosur qartazi një tavan për sasinë e kandidaturave që mund të shtohen nga subjektet zgjedhore në lista. Natyrshëm ky rregull mund të kuptohet në dy mënyra:

(1) se synon të përcaktojë një numri fiks në lista dhe për rrjedhojë duhen shtuar edhe aq kandidatë sa të arrihet plotpjestueshmëria me 3, ose

(2) se mund të shtohen kandidatë sipas preferencës, mundësisë dhe strategjisë së subjektit zgjedhor, mjafton të ruhet përpjestueshmëria me 3 dhe të sigurohet që “... informacioni i përcjellë nga fleta e votimit të mos jetë tejet i ngarkuar, konfigurimi i fletës të jetë i qartë e i kuptueshëm për zgjedhësin dhe zgjedhësi ta ketë të lehtë orientimin për votimin e subjektit zgjedhor dhe të kandidatit të parapëlqyer” (*neni 98(4) i Kodit Zgjedhor*). Kjo e fundit është çështje fakti që duhet provuar në gjykatë.

IV) Për koalicionet përbri emrit të kandidatit shënohet cilës parti i përket kandidati. Edhe ky rregull formal paraqitet mjaft i qartë dhe synon

të rregullojë një aspekt tjetër nga tre rregullat e tjera që gjenden në tre fjalitë e mësipërme.

7. Referuar sa më sipër, vlerësoj se leximi që i është bërë nenit 67(4) nga Komisioneri është në kundërshtim me ligjin, pasi lë pa zbatim kuptimin e qartë të fjalisë së dytë të këtij neni, në lidhje me shprehjen “shtuar 2”. Nëse ligjvënësi do të kishte synuar të bënte një rregullim si ai që lexon Komisioneri apo shumica e Kolegji Zgjedhor Gjyqësor, do të kishte pasur mundësi të thoshte “shtuar deri në 2” e jo të përdorte një shprehje jo dykuptimëshe si ajo “shtuar 2”. Po aq e kotë është përpjekja për të gjetur racione e shprehjes “shtuar 2”, me arsyetime që bien ndesh me kuptimin e drejtpërdrejtë të normës, sa ç’është përpjekja për të kuptuar se përse Kryetari i Partisë në dallim nga kandidatët e tjerë për deputetë mund të regjistrohet si kandidat deri në 4 zona zgjedhore, sipas rregullit të parashikuar nga neni 67(3), sipas të cilit “3. Kandidati për deputet, i regjistruar në një listë shumemërore në një zonë zgjedhore, ose kandidati për kryetar bashkie apo për këshillin e bashkisë nuk mund të regjistrohet si i tillë për një zonë zgjedhore tjetër, qoftë edhe për llogari të një partie apo koalicioni tjetër dhe as si i propozuar nga një grup zgjedhësish. Bën përjashtim nga ky rregull kryetari i partisë apo i partisë udhëheqëse të koalicionit, i cili në zgjedhjet për Kuvendin mund të regjistrohet deri në katër zona zgjedhore. Pas shpërndarjes së mandateve, sipas këtij ligji, ai nuk mund të zotërojë më shumë se një mandat, të cilin e zgjedh me vullnetin e tij të lirë.”

8. Edhe nëse pranohet arsyetimi i Komisionerit dhe shumicës së Kolegjit Zgjedhor se neni 67(4) i Kodit Zgjedhor nuk përcakton numrin minimal të kandidatëve në listën shumemërore, por tregon se sa është ky numër, prapë se prapë llogaritja e tyre është e gabuar. Kjo pasi leximi i tyre i normës, e lë pa zbatim shprehjen “shtuar 2”, ose në rastin më të mirë e zbaton vetëm atëherë kur nëse i shtohet numrit të vendeve për deputet, bëhet një numër i plotpjesëtueshëm me 3. Siç kam sqaruar edhe më sipër, ky është një lexim në drejtim krejt të kundërt me kuptimin e dispozitës dhe qëllimit të saj. Shprehja “shtuar 2” është aq e qartë, sa vetëm nëse nuk dëshirohet zbatimi i nenit 67(4) të Kodit Zgjedhor, mund të lexohet sikur të ishte shkruar “shtuar deri në 2”, ose “shtuar 0 ose 1 ose 2”.

9. Keqleximi i rregullave të nenit 67(4) të Kodit Zgjedhor, rrit shumë probabilitetin që të cenohet mbarëvajtja e Kuvendit në të ardhmen, pasi p.sh: nëse në një zonë zgjedhore si ajo e Kukësit, ku ka vetëm 3 mandate deputeti dhe lista sipas Komisionerit dhe shumicës së Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor duhet të përmbajë vetëm 3 kandidatë (nga së paku 6 që nxjerr në pah kuptimi i drejtë i normës), atëherë partia (kushdo qoftë ajo) që fiton vetëm 2 mandate do të mbetet e papërfaqësuar nëse më pas për shkaqe objektive një kandidat fitues i saj e humbet mandatin (sipas nenit 71 të Kushtetutës), ndërsa kandidati i tretë po për shkaqe objektive është në pamundësi për të marrë mandatin e atij që e humbi sipas nenit 164 të Kodit Zgjedhor. Leximi korrekt i nenit 67(4) i Kodit Zgjedhor në harmoni me dispozitat e tjera të këtij Kodi, do të duhej të krijonte rregulla loje që të garantonin maksimalisht mbarëvajtjen e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, i cili në rrethana specifike, mund të dëmtohej rëndë. Ndaj mendoj se neni 67(4) i Kodit Zgjedhor ka brenda vetes vizionin e

mosbllokimit të veprimtarisë së Kuvendit, si institucioni më i lartë shtetëror i Republikës së Shqipërisë dhe platea e demokracisë sonë.

10. Nisur nga sa më sipër vendimi nr.156, datë: 17.03.2021 i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve ka cenuar të drejtat dhe interesat e ligjshme zgjedhore të personit të interesuar PD-AN, pasi së paku nga 164 që është minimumi i kandidatëve në lista që duhej të kishte ky koalicion (*pa llogaritur këtu numrat e kandidatëve që duhen shtuar për të realizuar përpjestueshmërinë me 3*), e ka shkurtuar atë në 153, duke u bazuar në kritere që as nuk kishte kompetencë funksionale t'i vendoste. Kjo pasi në kuptim të nenit 12(4) të Kodit Zgjedhor "*[k]omisioni Rregullator (Rregullatori) është organi kompetent për miratimin e akteve me karakter normativ në fushën e zgjedhjeve dhe **vendosjen e rregullave për zgjedhjet.***" Nëse Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve do ta vërente të dyshimtë situatën e rregulluar nga neni 67(4) i Kodit Zgjedhor, ai duhej që në zbatim të neneve 19(1)(c) dhe 20(1)(a)(b) të Kodit Zgjedhor të vinte në lëvizje Rregullatorin, në mënyrë që ky i fundit të mund të normonte njësoj dhe paraprakisht për të gjithë subjektet zgjedhore kriteret dysHEME dhe tavan apo një numër fiks të kandidatëve (*nëse do e vlerësonte të arsyeshme për shkak të vështirësive që mund t'i shkaktoheshin fletëve të votimit, nëse nuk do të kishte limit të numrit të kandidatëve për deputetë*) për paraqitjen e listave me kandidatë për deputetë. Postimet në rrjetet sociale të Komisionerit nuk janë me karakter detyrues dhe janë nxjerrë në tejkalim të tagrave të tij ligjore, ndaj me të drejtë nuk janë marrë për bazë nga personi i interesuar PD-AN, ndonëse janë marrë për bazë nga subjektet e tjera zgjedhore siç është edhe paditësi PS, ku edhe këtij i janë shkelur të drejtat nga kufizimi me numrin 153. Ndaj, PS legjitimohej të kundërshtonte vendimin e Komisionerit për listat e veta, e jo të kundërshtojë vendimin e KAS për listat e kundërshtarit politik PD-AN, pa provuar se ku e cenon konkretisht atë. Fakti që PS e ka marrë të mirëqenë qëndrimin e Komisionerit jashtë tagrave ligjore që i njeh Kodi Zgjedhor atij, nuk mund të jetë detyrues për PD-AN, të cilët kanë konstatuar se kufizimi me 153 kandidatë për deputetë në lista, përbën cenim të minimumit të kandidatëve që lejon të paraqiten neni 67(4) i Kodit Zgjedhor.

11. Veprimet e mësipërme në kundërshtim me ligjin të Komisionerit kanë sjellë si rezultat se për zgjedhjet e 25 prillit 2021 praktikisht të gjitha listat janë nën minimumin ligjor që përcakton neni 67(4) i Kodit Zgjedhor, duke sjellë potencialisht problematika në të ardhmen. Po ashtu, kjo çështje e vë Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor para përgjegjësisë së krijimit rishtazi të normave pozitive, çka nuk është në tagrin e gjykatës. Kolegji Zgjedhor Gjyqësor i nënshtrohet vetëm Kushtetutës dhe Kodit Zgjedhor dhe eventalisht mund të merrte në shqyrtim çështjen e minimumit dhe maksimumit të listave të subjekteve zgjedhore, apo numrit fiks të tyre, vetëm pasi Komisioni Rregullator të kishte nxjerrë një akt normativ në këtë drejtim (*dhe ky akt të ankimohej nga palët e interesuara*), gjë e cila nuk ka ndodhur. Nëse Komisioneri do të kishte venë në lëvizje Rregullatorin për nxjerrjen e një akti të tillë, do të ishte shmangur perceptimi i paditësit se cenohet barazia e tij në garë me PD-AN, për shkak të listave me më shumë kandidatë të këtij të fundit. Kjo pasi të gjitha palët do të dinin para fillimit të garës, se cilat janë rregullat e saj, të përcaktuara nga organi kompetent.

12. Në përfundim, jam i mendimit se vendimi nr.156, datë: 17.03.2021 i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve është i gabuar, i marrë në kundërshtim me kriteret e nenit 67(4) të Kodit Zgjedhor dhe duhej ndryshuar nga KAS. Ndërsa sa i përket vendimmarrjeve të mundshme të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor, mendoj se nga shumica u mor e vetmja që ishte më e gabuara, ndërsa çmoj se mund të ishte zgjedhur së paku midis dy alternativave të tjera më të bazuara në ligj, që ishin si vijon:

a) Rrëzimi i padisë pasi:

- Paditësi nuk legjitimohet në ngritjen e saj;
- Paditësi nuk ka formuar drejtë ndërgjyqësinë, pasi PD-AN nuk mund të ishte person i interesuar në këtë çështje, por vetëm i paditur, për shkak se cenoheshin drejtpërdrejtë të drejtat dhe interesat e tij të ligjshme, nga ndryshimi i vendimeve të KQZ-së;
- Komisioneri ka marrë një vendim të pambështetur në ligj, duke marrë përsipër tagra që nuk ia njeh Kodi Zgjedhor, por që i përkasin Komisionit Rregullator;
- Neni 67(4) nuk ka të përcaktuar qartë numrin sipëror të listave të kandidatëve për deputetë që mund të paraqesin subjektet zgjedhore dhe në mungesë të një normimi paraprak nga Komisioni Rregullator i KQZ, nuk ka shkak të cenohesit kuptimi i PD-AN në lidhje me numrin e kandidatëve, pasi kishte filluar tashmë gara zgjedhore;
- Përveç pretendimeve hipotetike për cenim të barazisë (*duhet theksuar se në këtë rast barazia është barazi mundësisht dhe jo listash*) nuk u provua në gjykim as nga pala paditëse dhe as nga i padituri, se si konkretisht dhe efektivisht e dëmton fletën e votimit apo procesin zgjedhor fakti që PD-AN ka paraqitur listat me 222 kandidatë për deputetë.

b) Pranimin e pjesshëm të padisë dhe ndryshimin e vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe atij të KAS, duke kryer vetë Kolegji Zgjedhor Gjyqësor (KZGj) miratimin e cinguar të listave të PD-AN sipas rregullit që lidhet me përcaktimin nga Kolegji Zgjedhor të një numri fikse të kandidaturave për deputetë në çdo zonë zgjedhore. Kjo do të bëhej duke marrë për bazë sa është numri i mandateve për deputet në atë zonë, shtuar 2 dhe korrigjuar nëse numri që dilte ishte jo i përpjestueshëm me 3, duke u shtuar eventualisht edhe 1 apo 2 kandidatë, me qëllim plotësimin e kriterit gjinor dhe përpjestimor. Kjo zgjidhje është më pak e preferuara, pasi në këtë rast detyrohet Kolegji Zgjedhor Gjyqësor që praktikisht të normojë pozitivisht një rregull, pas fillimit të garës zgjedhore, çka nuk është një zgjedhje e pëlqyeshme në kuptim të procesit të rregullt ligjor. Por gjithësesi kjo do të mund të bëhej nga KZGj, në kuadër të zgjidhjes së mosmarrëveshjes zgjedhore, meqë as Komisioneri e as ndonjë anëtar i Rregullatorit nuk e kanë parë të arsyeshme të iniciojnë një procedurë para Rregullatorit për saktësimin e numrit fikse (*në vështrim të mosrëndimit të zbatimit të nenit 98 të Kodit Zgjedhor, në lidhje me përmbajtjen e fletëve të votimit*) që duhet të përmbajnë listat e subjekteve politike zgjedhore, që të gjente zbatim universal paraprak për të gjithë subjektet zgjedhore. Në këtë mënyrë Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor do i binte barra të saktësonte vetë këtë

rregull me rëndësi për zgjedhjet, i cili do të ishte parakusht për zgjidhjen e mosmarrëveshjes midis palëve. Më pas paditësi PS mund të kërkonte nga Komisioneri që para se të miratohej fleta e votimit të ndreqte edhe ai listat e tij, në bazë të orientimeve detyruese të dhëna nga Kolegji Zgjedhor Gjyqësor.

13. Në zbatim të nenit 159(5) të Kodit Zgjedhor ky mendim pakice i bashkëlidhet vendimit të shumicës.

GJYQTAR

Asim VOKSHI